



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	14.08.2019
REFERENC-Ë:	18/5833/730/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Guri Company" Sh.p.k. Gërçar- Viti Eksplotim të gurit gëlqeror në Gërçar- Viti
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "Guri Company" Sh.p.k. Gërçar- Viti, me nr. prot. 18/5833/730/DMMU, të datës 09.10.2018.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartcekur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për refuzim të kërkesës për Leje Mjedisore për kompaninë "Guri Company" Sh.p.k. Gërçar- Viti, për eksploatim të gurit gëlqeror në Gërçar- Viti.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Refuzim i kërkesës për Leje Mjedisore

Kompanisë "Guri Company" Sh.p.k. Gërçar- Viti, për eksploatim të gurit gëlqeror në Gërçar- Viti.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "Guri Company" Sh.p.k. Gërçar- Viti, për eksploatim të gurit gëlqeror në ngastrat kadastrale nr.1086/6 , Certifikata, nr. P-70101015-01086-6, zona kadastrale Gërçar- Viti, komisioni për Leje Mjedisore pas realizimit të vizitës në teren ka kërkuar nga kompania që të plotësoj informata shtesë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; merr vendim për **Refuzimin e kërkesës për Leje Mjedisore** të kompanisë "Guri Company" Sh.p.k. Gërçar- Viti, për eksploatim të gurit gëlqeror në Gërçar- Viti, pasi që Leja e KPMM-së nuk përputhet me të dhënat e përshkruara në kërkesën e bërë për tu pajisur me Leje Mjedisore dhe Pëlqimit Mjedisor.

Faqe 2 nga 3



Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/5833//ZSP/416/19 datë: 14.08.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komünës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së



Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Department of Environment Protection and Water /
Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu

DATË/A:	14.08.2019
REFERENC-Ë:	18/5833/730/DMMU
PËR/ZA/TO:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave <i>Kelley</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Flet përcjellëse

Bazuar në kërkesën e bërë nga kompania "Guri Company" Sh.p.k. Gërçar- Viti, me nr. prot. 18/5833/730/DMMU, për tu pajisur me Leje Mjedisore, për eksploatim të gurit gëlqeror në Gërçar- Viti, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1